



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.101 dt.28.09.2001

**PER
MIRATIMIN E STRUKTURES SE NJESISE SE SHQYRTIMIT TE NDERTIMEVE PA
LEJE**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin “Për miratimin e strukturës së Njesisë së Shqyrtimit të ndërtimeve pa leje”, mbështetur në ligjin 8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, nenin 4 të ligjit 8654 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”, në nenin 77 të ligjit “Për Urbanistikën”, Nr.8405, dt.17.09.1998, si dhe në zbatim të VKM. 394 dt.31.05.2001 “Për financimin e projektit për legalizimin e ndërtimeve pa leje të ndërtuara para datës 25.10.1998, në Bashkinë e Tiranës dhe të shkresës nr. 3826/4 prot. Dt.17.08.2001 të Ministrisë së Financave “Për detajim fondesh”

V E N D O S I

1. Të miratojë Projektin “Për shqyrtimin e ndërtimeve pa leje, të ndërtuara para dt.25.10.1998, në Bashkinë e Tiranës
2. Të miratojë strukturën e Njesisë së Shqyrtimit të ndërtimeve pa leje
3. Struktura e Njesisë së Shqyrtimit të ndërtimeve pa leje të jetë:

Kualifikim	Numri i personave
Drejtori i strukturës	1 person
Shefi i Sektorit të Trajtimit	1 person
Spektori i Trajtimit të Kërkesave	10 persona
Shef i Sektorit të	1 person

Azhornimeve	
Sektori i Azhornimeve	7 persona

4. Pagesa e punonjësve të strukturës së Njesisë së Shqyrtimit të ndërtimeve pa leje, të jetë sipas tabelës së pagesave të miratuar për Bashkinë Tiranë
5. Fondet për funksionimin e strukturës së Njesisë së Shqyrtimit të ndërtimeve pa leje, të përballohen nga Fondet buxhetore të detajuara nga Ministria e Financës
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Urban, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike me zbatimin e këtij vendimi
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

